

## Mirë me dit

Orari i punës / ditët festive

Titulli i qëndrimit dhe marrja e nënshtetësisë (DE)

Sigurimie private me detyrim zhdëmtimi

Alkooli / duhani / droga

Shtazët shtëpiake

Kështu frymon Zvicra

## Orari i punës / ditët festive

Në Zvicër janë pothuajse të gjitha shitoret në ditën e diel të mbyllura. Përjashtim bëjnë shitoret në stacionet e trenit. Ditët festive janë të rregulluara me ligj në kantone.

### Ditët festive

Ditët festive janë me ligjin për punë të rregulluara dhe të njëta si ditët e diela. Një gushti (dita festive nacionale) është në të gjithë Zvicrën me ligj një ditë festive. çdo kanton mundet edhe tetë ditë të tjera zyrtarisht t'i vendos si ditë festive. Në kantonin Basel-Landschaft ditët festive janë këto festa zyrtare: Viti i ri (1 janar), Karfreitag (e premtja para pashkëve), e hëna e pashkëve, dita e punës (1 maj), ngritja në qiell (e enjte 40 ditë pas të dieles të pashkëve), e hëna e Pashkëve, festa nacionale (1. gusht), Bettag, Krishtlindjet (25 dhjetor), dita e Stefanit (26 dhjetor).

### Orari i punës në shitore

Orarët e punës në shitore janë kantonalisht të ndryshme. Në kantonin Basel-Landschaft nuk ka urdhër të shtetit mbi orarin e punës. Shumica e dyqaneve ushqimore janë të hapura nga e hëna në të premte nga ora 08:00 deri në orën 19:00. Sidoqoftë, kohët mund të ndryshojnë në varësi të dyqanit dhe mund të jenë më të shkurtra ose më të gjata. Të shtunën mbyllen shumica e shitoreve më herët se përgjatë javës. Të dielen janë shumica e shitoreve të mbyllura. Përjashtim bëjnë shitoret në stacionet e trenave ose pikat e karburantit, që normalisht 7 ditë janë të hapura dhe në të shumtën e rasteve hapen më herët dhe mbyllen më vonë se të tjerat.

### Orari i punës në administratën publike

Administra kantonale është sipas rregullit prej të hënës deri të premtën 8.00 deri 12.00 dhe prej 14.00 deri 17.00 e hapur. Disa vende hapen mbasdite prej 13.30 apo janë më gjatë me telefon të arritshme. Orari i punës i administratës nëpër komuna është shumë i ndryshëm. Para s`gjithash në komunat e vogla mundet me qenë orari i punës i kufizuar. Është e këshillueshme në çdo rast, më parë përmes internetit apo telefonit të njoftohesh për orarin e punës, se kur janë sportelet e hapura.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/orari-i-punes--ditet-festive](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/orari-i-punes--ditet-festive)

# Titulli i qëndrimit dhe marrja e nënshtetësisë (DE)

Për të banuar më gjatë në Zvicër apo për të punuar, është nevojshme leja. Njeriu dallon leje të ndryshme qëndrimi dhe leje me vendqëndrim.

## Llojet e lejës

Kush gjatë qëndrimit në Zvicër punon apo qëndron më shumë se tre muaj, i nevojitet për këtë një leje. Kjo bëhet prej zyrës kantonale për Migrimin dhe të drejtat e qytetarëve (Amt für Migration und Bürgerrecht). Dallohet në mes lejeve të shkurtëra të qëndrimit (deri 1 vit), leje qëndrimi (të kufizuara) dhe leje qëndrimi (të pa kufizuara) dhe lejeve të udhëtarëve ndërkufitarë.

- Leja e shkurtër e qëndrimit (L): Kjo leje është për personat, të cilët për një kohë të caktuar (më së shumti një vit) për një arsye të caktuar jetojnë në Zvicër. Në përgjithësi banoret dhe banorët nga shtetet EU-/EFTA, që mund ta dëshmojnë një marrdhënie pune prej 3 muaj deri në një vit (kontratë pune), kanë të drejtën e kësaj leje.
- Leja e qëndrimit (B): Kjo leje është për personat, të cilët kanë qëndruar gjatë në Zvicër. Shumica e banoreve dhe banorëve prej shteteve të EU/EFTA, kanë një të drejtë për këtë, nëse mund ta dëshmojnë, që më shumë se një vit kanë punuar në Zvicër (kontratë pune). Leja e qëndrimit u ndahet banoreve dhe banorëve të EU/EFTA për pesë vite. Për personat nga shtetet e tjera është leja e vlefshme për një vit. Pastaj duhet të qitet kërkesa për vazhdim. Vazhdimi mundet te këta personat të ndërlihet me kushte, p.sh. shkuarja në një kurs të gjuhës gjermane. Të drejtën për vazhdim nuk e kanë. Arsyet, që flasin kundër një vazhdimi mund të jenë, p.sh. shkelja e ligjit ose varësia nga ndihma sociale. Leja e qëndrimit skadon nëse qëndroni jashtë vendit për më shumë se gjashtë muaj pa ndërprerje.. Edhe refugjatët të pranuar e marrin vizën-B.
- Leja me vendqëndrim (C): Këtë leje e merr njeriu pas 5 apo 10 vite qëndrimi në Zvicër. Kjo leje me vendqëndrim nuk mund të ndërlihet me kushte. Nëse lëvizni jashtë vendit, mund ta mbani lejen e qëndrimit të përhershëm për një maksimum prej katër vjetësh në kushte të caktuara. Për këtë duhet bërë një aplikim në Zyrën për Migracionin dhe të Drejtat Civile.
- Pranime të përkohshme (F): Këtë leje e marrin kërkuesit e azilit, të cilët nuk pranohen si refugjatë, mirëpo merren përkohësisht. Leja duhet çdo vit të vazhdohet.

## Letërnjoftimi për të huaj

Të huajat dhe të huajt, që banojnë në Zvicër, e marrin një letërnjoftim për të huaj (Ausländerausweis). Lloji i letërnjoftimit është i varur prej kritereve të ndryshme. Ka letërnjoftime në formatin e kartelës të kredisë dhe letërnjoftime nga letra (letërnjoftim jo biometrik për të huaj, nicht biometrischer Ausländerausweis). Disa persona e marrin një letërnjoftim biometrik për të huaj. Ky letërnjoftim e ka një çip për të dhëna, merren shenjat e gishtave dhe një fotografi. Ata duhet të kenë të dhënat e tyre biometrike të regjistruara në Zyrën për Migracionin dhe të Drejtat e Qytetarëve. Të gjithë të sapoardhurit që nuk flasin gjermanisht ftohen gjithashtu në një takim fillestar informues, ku marrin informacione të rëndësishme për ardhjen e tyre. Nëse vidhet letërnjoftimi apo humbet, duhet menjëherë të lajmërohet në polici.

## Vazhdimi

Nga lloji i statusit të qëndrimit dhe përkatësia shtetërore duhet leja e qëndrimit në kohë të ndryshme të vazhdohet. Nëse është një vazhdim i nevojshëm, e merr njeriu një formular (Verfallsanzeige). Ky formular duhet të plotësohet, të konfirmohet nga punëdhënësi dhe më pas t'i dërgohet Zyres për Migrimin dhe të Drejtat e Qytetarëve (Amt für Migration und Bürgerrecht) së bashku me një kopje të pasaportës ose kartës së identitetit tuaj të shtëpisë (për BE/EFTA). Për pyetje informojnë komunat përkatëse apo Zyra për Migrim dhe të Drejtat e Qytetarëve.

## Marrja e zakonshme e nënshtetësisë

Kushdo që ka jetuar në Zvicër për dhjetë vjet mund të aplikojë për një leje federale për marrjen e nënshtetësisë. Vitet e kaluara në Zvicër nga mosha 8 deri në 18 vjeç numërohen dyfish. Parakushte të rëndësishme për marrjen e nënshtetësisë janë përmbushja e periudhës së qëndrimit, njohja e gjuhës gjermane, integrimi dhe të dhënat e mira financiare dhe kriminale.

## Marrja e nënshtetësisë me lehtësira

Nën kushte të caktuara ligjore, marrja e nënshtetësisë me lehtësira është kryesisht për bashkëshortët e huaj të shtetasve zviceranë dhe pasardhësit e një prindi zviceran. Në rastin e marrjes së nënshtetësisë me lehtësira, është vetëm qeveria federale ajo që vendos.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/titulli-i-qendrimit](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/titulli-i-qendrimit)

## Sigurimie private me detyrim zhdëmtimi

Çdo person i rritur do të duhej ta bënte një sigurim privat me detyrim zhdëmtimi. Ky merr shpenzimet, kur njeriu dikujt padashje i shkakton dëm.

### Zhdëmtimi personal

Kur njeriu një person tjetër e lëndon apo ndonjë gjë e dëmton, që një personi tjetër i takon, për këtë detyrohet njeriu financiarisht. Kjo vlen edhe atëherë, kur dëmet nuk janë shkaktuar me qëllim. Shpenzimet munden me qenë shumë të larta. Kur njeriu si shembull dikend gjatë ngasjes të skive e lëndon, munden dëmet të shkojnë qindramijëra franga.

### Sigurimi privat me detyrim zhdëmtimi

Për mos me hy në vështërsi financiare nëse ndodhë një dëm, i nevojitet njeriut një sigurim privat me detyrim zhdëmtimi (Privathaftpflichtversicherung). Ky ofertohej prej shumicës të sigurimeve private. Sigurimet private me detyrim zhdëmtimi munden shpesh të bëhen prej të gjithë personave që jetojnë bashkë. Ky sigurim nuk është i obligueshëm por preferohet patjetër.

### Shërbimet e sigurimit

Sigurimi privat me detyrim zhdëmtimi i mbulon dëmet në gjësende dhe persona, të cilat një person i siguruar i ka shkaktuar një tjetri. Këtu hyjn shpenzimet për riparim, shpenzimet për shërim, dëmet në rrogë apo para për dhembjet e shkaktuara. Sigurimi privat me detyrim zhdëmtimi i mbulon edhe shpenzimet dhe dëmet të cilat i shkaktojnë shtazët shtëpiake. Ky nuk paguan për dëmet që njeriu i shkakton personit të cilët jetojnë së bashku në shtëpi. Nuk mbulohen edhe shpenzimet, që njeriu i shkakton me qëllim apo pakujdesi.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/sigurimie-private-me-detyrim-zhdemtimi](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/sigurimie-private-me-detyrim-zhdemtimi)

## Alkooli / duhani / droga

Kush mban drogë, e konsumon apo e shet, e bënë veten të dënohet.  
Për shitje të alkoolit dhe duhanit është mosha e caktuar.

### Droga

Mbajtja, shitja apo konsumimi ilegal i drogës është i dënueshëm. Kjo vlen edhe për sasi të vogla. Cilat substanca janë ilegale, është e rregulluar me ligjin për mjete narkotike (Betäubungsmittelgesetz). Shitja e drogës në mënyrë profesionale ndëshkohet me dënime të larta.

### Alkooli dhe duhani

Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufizim të moshës. Kështu duhani dhe pijet alkoolike në kantonin Basel-Landschaft nuk guxojnë tu shiten të rinjëve nën 16 vjeç. Për pije alkoolike të posaçme si spirituset, kufiri në moshë qëndron te 18 vjeç.

### Ndalimi i pirjes të duhanit

Ndalimi i pirjes të duhanit në Zvicër është kantonalisht ndryshueshëm i rregulluar. Kantoni Basel-Landschaft mbështetet në ligjin e shtetit për mbrojtjen e duhanpirësve pasiv dhe dhe ligji kantonal i kulinarise.

Ndalim i pirjes të duhanit vlen në:

- Në hapësirat e mbyllura, në hapësirat e hapura të frekuentuara (Spitalet, administratat, shkollat, muset, kino, teatri, treni, autobusat, shitoret, dhe qendrat për blerje).
- Hapësirat, në të cilat shumë persona e kanë vendin e tyre të punës.

Se a është e lejuar të pihet duhan në restorant, mvaret nga madhësia e restorantit. Në shumë restorane ka dhoma për pirjen e duhanit.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/alkooli--duhani--droga](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/alkooli--duhani--droga)

## Shtazët shtëpiake

Kush mban shtazë shtëpiake, duhet tu përmbahet rregullave të ndryshme. Kështu disa lloje të shtazëve nuk guxojnë të mbahen në çdo banesë. Komunat mund të caktojnë tarifa për qentë.

### Mbajtja e shtazëve shtëpiake

Kush jeton në një banesë me qira, në çdo rast guxon të mbajë kafshë të vogla, si derra Indie, brejtës, kanarina apo peshq. Mirëpo mund të jetë, që mbajtja e kafshëve më të mëdha (edhe macet apo qent e vegjël) janë të ndaluar në kontratën e qirasë. Edhe shtazët që shkaktojnë zhurmë apo janë të rrezikshme, qiradhënësi mundet t`i ndalojë. Përveç kësaj duhet që mbajtëset dhe mbajtësit e shtazëve ta respektojnë ligjin për mbrojtjen e kafshëve. Për shembull, njeru nuk guxon disa shtazë t`i mbaj të vetëm (p.sh. lepujt). Po ashtu është e përcaktuar madhësia e kafazit dhe rregullimi i tij. Shumë shtazë (shtazë egzotike) nuk guxojnë fare të sillen në Zvicër. Për disa të tjera nevojitet një leje speciale nga zyra e veterinarëve.

### Qenët

Në kantonin e Basel-Landschaft ka një ligj special për qenë. Aty është e vendosur se çfarë detyra kanë mbajteset dhe mbajtësit e qenëve. Më shumë informacione mund të jep mjeku apo mjekja e shtazëve.

- Të gjithë qenët në Zvicër duhet të shënjohej me një mikroçip dhe të përpilohet një bank të dhënash. Qeni ka një letërnjoftim për qenë (format i kartës për kredi). Ky nuk është identik me letërnjoftimin shtëpiak për shtazë, të cilin i nevojitet njeriut nëse don të udhëtoj me shtazë në vendet e unionit evropian.
- Qenët duhet të lajmërohen në komunën e banimit. Komunat mund të caktojnë tarifa për qentë. Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë (Haftpflichtversicherung) gjithashtu duhet të merret për mbajtjen e çdo qeni.
- Të gjithë mbajtësit e qenëve duhet ta hjekin jashtëqitjen e qenit të tyre. Kush nuk e bënë këtë, mund të marr një dënim.
- Për disa rasa të qenëve nevojitet një leje speciale (p.sh. pitbulli apo rottweiler).

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/shtazet-shtepiake](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/shtazet-shtepiake)

## Kështu frymon Zvicra

Secili vend ka të veçantat kulturore të vetat. Kështu ka edhe në Zvicër disa ligje të pashkuara, të cilat njeriu duhet t`i vërej.

### **Kultura të ndryshme**

Zvicra është një vend i përzier me kultura të ndryshme. Kjo dhe shkaku i katër gjuhëve të ndryshme. Kështu nuk është e çuditëshme, që mentalitet në rajone janë shumë të ndryshme. Të përbashkat kulturore të Zvicrës gjermane nuk do të thotë të vlejnjë edhe për Zvicrën franceze. Edhe dallimet në mes qyteteve dhe rajoneve të fshatit mund të jenë të mëdha. Ka edhe disa të përbashkta.

### **Përsëndetjet**

Gjatë përsëndetjes në Zvicër njeriu e jap dorën dhe shikon në sy, edhe në mes grave dhe burrave. Përsëndetja formale është "Grüezi" (në mes shokëve ka tjera forma të përsëndetjes, si "Hallo" oder "Hoi"). Në rajonet e fshatrave përsëndet njeriu sipas rregullit në rrugë, edhe kur dikend nuk e njeh. Të rëndësishme janë edhe shprehjet "Danke" dhe "Bitte": p.sh. në shitore dhe restorane është gati si një ritual, që njeriu shumë herë thot "Danke" dhe "Bitte".

### **Përpikëria**

Te Zvicranët e famshëm përpikëria nuk ka të bëjë vetëm me një klishe. Nëse njeriu vonohet më shumë se 5 minuta, duhet njeriu të lajmroj me telefon. Posaçërisht në botën e punës vëhet shumë rëndësi në përpikëri. Nëse njeriu don të takohet, normalisht e bënë njeriu më parë një termin. Vizitat e pa paralajmëruara nuk bëhen sipas rregullit edhe në rrethin privat.

### **Komunikimi indirekt**

Në Zvicër shprehet njeriu për gjëra të pakëndëshme shpesh indirekt. Shumë partner të bisedave shprehin kritikë vetëm mfsheftas dhe mfsihien pas frazave. Pastaj, presin, që kjo kritikë të pranohet. Kjo nuk është e lehtë, kur njeriu nuk flet ende perfekt gjermanisht. Meqë njeriu don ta ruaj harmonin, në situata konfliktuoze shpesh i shmanget një konfrontimi direkt. Kështu mund të ndodh, që njeriu për shembull e merr një letër prej fqinjit, kur atij diç i pengon. Te paqartësit pyet njeriu më mirë një herë më shumë se pak.

### **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/keshtu-frymon-zvicra](http://www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/keshtu-frymon-zvicra)